



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.73/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj – kryesuese, Bujar Muzaqi dhe Hajriz Hoti - anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së Bekim Haxhiut kandidat për deputet nga subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër administrimit të procesit të numërimit dhe shpalljen si të vlefshme të fletëvotimeve të dërguar me postë nga votimi jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.01.2026, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET E PASAFATSHME ankesa ZP.Anr.73/2026, e datës 11.01.2026, e parashtruar nga Bekim Haxhiu kandidat për deputet nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të anulohet të gjitha fletëvotimet të pranuar me postë pas datë 29.12.2025 dhe të përjashtoj nga numërimi të gjitha fletëvotimet të pranuar pas këtij afati përfshirë ato të pranuar me 02.01.2026 dhe 05.01.2026, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 11.01.2026, PZAP-i, ka pranuar ankesën ZP.Anr.73/2026 nga Bekim Haxhiu kandidat për deputet nga subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në të cilën thekson se në bazë të nenit 105 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, përcaktohet e drejta për parashtrimin e ankesës në afat prej 48 orësh nga ndodhja e shkeljes së supozuar në procesin e QNR dhe në këtë kuptim, ankesa është e pranueshme si nga aspekti formal ashtu edhe procedural, sepse ka të bëjë me ligjshmërinë e përfshirjes në numërim të një kategorie fletëvotimesh pas afati ligjor në rezultatin zgjedhor, çka përbën element vendimtar të aktit përfundimtar të shpalljes dhe certifikimit, e cila është bërë e ditur zyrtarisht nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në njoftimin e publikuar të datës 9 janar 2026, ku ndër të tjerash është përcaktuar shprehimisht edhe e drejta në ushtrimin e ankesave në afatin prej 48 orësh lidhur me administrimin e numërimit në QNR. Për këtë arsye, kompetencat e PZAP-it për të ndërmarrë masa që sigurojnë ligjshmërinë dhe integritetin e procesit zgjedhor, përfshirë urdhërimin e

shpalljes së pavlefshme dhe përjashtimin nga rezultatet të fletëvotimeve me postë të pranuar pas afatit ligjor të nenit 96 paragrafi 2, burojnë jo vetëm nga ligji, por edhe nga rregullorja procedurale për ankesat, e cila është ndërtuar pikërisht për të garantuar zgjidhje efektive, të shpejtë dhe të orientuara drejt provës, në mënyrë që procesi të mos prodhojë rezultate të pakthyeshme mbi bazën e shkeljeve të pa adresuara.

Ankuesi thekson se kërkesa e tij që të verifikohet dhe të korrigjohet përfshirja e fletëvotimeve të pranuar pas afatit ligjor nuk është vetëm e lejuar, por është në përputhje me funksionin kushtetues dhe ligjor të PZAP-it si mekanizëm i kontrollit të ligjshmërisë së procesit zgjedhor para certifikimit të rezultatit përfundimtar, pasi që 28 dhjetor 2025 janë mbajtur zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, në Kapitullin XIV, përkatësisht në nenin 96, rregullon votimin jashtë Kosovës dhe përcakton një kriter të prerë për vlefshmërinë e fletëvotimit me postë: fletëvotimet e dërguara me postë pranohen nga KQZ-ja vetëm deri të nesërmen e ditës së zgjedhjeve në orën 16:00, me kusht që të kenë vulën postare para ditës së zgjedhjeve. Kjo dispozitë nënkupton se afati maksimal dhe absolut për pranimin e fletëvotimeve me postë ka qenë data 29 dhjetor 2025, ora 16:00.

Parashtruesi i ankesës thekson se pavarësisht këtij afati ligjor të prerë, KQZ ka nxjerrë Vendimin Nr. 01/3794-2025, me të cilin është miratuar rekomandimi për afatet dhe veprimet për dërgimin dhe pranimin e pakove me fletëvotime për votim me postë, ku parashihet tërheqja e pakove nga kutitë postare edhe më 02.01.2026, respektivisht në ditën pasuese të punës nëse shërbimet postare nuk funksionojnë, andaj ky vendim ka hapur rrugën për administrimin faktik të fletëvotimeve edhe pas afatit të përcaktuar me ligj, duke e zhvendosur standardin e pranimin nga afati ligjor në afatin administrativ të tërheqjes, standard ky i panjohur për ligjin dhe i papranueshëm në të drejtën zgjedhore. Kjo praktikë është konfirmuar publikisht dhe pa mëdyshje nga vetë KQZ. Në njoftimin zyrtar të datës 07.01.2026, KQZ ka bërë të ditur se në vazhdim të procesit të numërimit do të përfshihen fletëvotimet nga votimi përmes postës të tërhequra më 2 dhe 5 janar 2026, duke specifikuar se më 2 janar janë tërhequr 8,180 pako me fletëvotime nga 9 kuti postare jashtë Kosovës, ndërsa më 5 janar janë tërhequr edhe 11,867 pako me fletëvotime nga 13 kuti postare dhe 3,185 pako me fletëvotime nga 5 kuti postare, në total 23,232 pako me fletëvotime nga 13 kuti postare janë administruar dhe numëruar deri në datë 09.01.2026 sipas njoftimit zyrtarë të KQZ.

Sipas praktikës së deritanishme, ligjit për zgjedhjet dhe rregullores zgjedhore 14/2024, kur pako me fletëvotime me postë, kanë arritur në QNR, pas afatit ligjorë, ato nuk janë pranuar por janë dërguar për vendimmarrje në KQZ, PAZAP dhe Gjykatës Supreme.

Tabulimi në rezultatin zgjedhorë i fletëvotimeve me postë pas afati ligjorë përbën shkelje të Ligjit Nr. 08/1+228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, nenin 96, paragrafi 2.

Rrjedhimisht, është fakt i pranuar zyrtarisht se një numër i konsiderueshëm fletëvotimesh me postë është tërhequr, është sjellë në Kosovë, është verifikuar dhe është futur në numërim pas datës 29.12.2025 ora 16:00, çka, në kuptimin juridik, është ekuivalente me pranimin dhe

numërimin e fletëvotimeve jashtë afatit ligjor dhe, për pasojë, me shpalljen e tyre si të vlefshme në kundërshtim me normën imperative të nenit 96 paragrafi 2.

Pranimi dhe numërimi i fletëvotimeve pas afatit të 29.12.2025 ora 16:00 përbën shkelje të drejtpërdrejtë dhe flagrante të nenit 96 paragrafi 2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Ky afat nuk është udhëzues, as i negociueshëm, por kusht thelbësor për vlefshmërinë e votës. Në të drejtën zgjedhore, afatet që përcaktojnë mbylljen e procesit të votimit dhe pranimin e fletëvotimeve janë garanci e integritetit të procesit dhe barazisë së votës, sepse sigurojnë që rezultati të prodhohet nga një trup votuesish i mbyllur në kohë dhe i trajtuar njësoj

KQZ është organ administrativ kushtetues dhe nuk ka asnjë kompetencë ligjore për të ndryshuar, zgjatur, pezulluar apo relativizuar një afat të përcaktuar shprehimisht me ligj nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Vendimi administrativ Nr. 01/3794-2025, në masën që në praktikë lejon pranimin dhe numërimin e fletëvotimeve pas afatit ligjor, është veprim jashtë kompetencës dhe përbën zhvendosje të standardit ligjor me akt nënligjor, gjë që bie ndesh me parimin e ligjshmërisë, sigurinë juridike dhe hierarkinë e normave.

Sipas parashtruesit të ankesës kjo paligjshmëri ka efekt zinxhir në të gjitha komponentët e rezultatit, rrit numrin e votave të përfshira në shpërndarjen e mandateve, ndryshon peshën relative të votës, transformon rezultatet brenda listave të hapura dhe, në fund, prodhon renditje të ndryshme të kandidatëve dhe shpërndarje të ndryshme mandatesh. Kjo nuk është vetëm çështje e "votave të diasporës", por çështje e barazisë së votës dhe e integritetit të procesit në tërësi, pasi që ankuesi preket drejtpërdrejt nga administrimi i kundërligjshëm i fletëvotimeve me postë të pranuar pas datës 29.12.2025 ora 16:00, sepse këto fletëvotime ndikojnë në numrin e përgjithshëm të mandateve të subjektit politik PDK, si dhe në renditjen përfundimtare të kandidatëve brenda listës së hapur, pasi që në raportimet publike është bërë e ditur se PDK ka rënë nga 23 në 22 mandate, dhe se ankuesi është identifikuar si kandidati që e humb ulësen në këtë ndryshim të mandateve.

Parashtruesi i ankesës thekson se sikurse që votimi brenda vendit ka një orar mbylljeje të pakapërcyeshëm, edhe votimi me postë ka afatin e fundit të pranimin të fletëvotimit, i cili shërben për të garantuar mbylljen e sigurt të procesit, verifikimin dhe numërimin e organizuar dhe të besueshëm, dhe kur afati tejkalohet dhe megjithatë vota numërohet, atëherë barazia e votuesve prishet dhe integriteti i procesit vihet në pikëpyetje. Parashtruesi i ankesës thekson se 28,232 pako me fletëvotime me postë janë pranuar brenda afatit ligjor sipas Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, nenin 96, paragrafi 2. dhe nuk janë objekt i ankesës, ndërsa, 23,232 pako me fletëvotime me postë janë pranuar pas afatit ligjor dhe janë objekt i ankesës, sepse janë të paligjshme dhe të barabarta me situatën hipotetike ku si të vlefshme do të pranoheshin edhe votat pas mbylljes së Qendrave të Votimit në Kosovë, më datë 28.12.2025, në ora 19:00.

Ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa, të urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që të anulohet të gjitha fletëvotimet e pranuar me postë të pranuar pas datës 29.12.2025 ora 16:00 dhe të përjashtojë nga numërimi të gjitha fletëvotimet me postë të pranuar pas këtij afati, tabelimi i të cilave në rezultatin zgjedhorë ka ndodhë deli më datën 09.01.2026, sipas njoftimit

zyrtarë të KQZ, si dhe të bëhet rishikimi i rezultatit zgjedhor pa përfshirjen e këtyre fletëvotimeve, në përputhje me nenin 13 paragrafi '12 nën paragrafi 12.2 të Rregullores Nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave.

Në përgjigje në ankesë KQZ ka theksuar se më datë 10.12.2025, KQZ nxori vendimin me numër 01/3794-2025 për miratimin e afateve dhe veprimeve operacionale për dërgimin dhe pranimin e pakove me fletëvotime përmes postës. Duke u bazuar në rekomandimin e Sekretariatit dhe duke marrë parasysh afatet e përcaktuara me vendimin e KQZ-së të datës (mbi kërkesat dhe specifikimet për shërbimet postare për votimin jashtë Kosovës), është konstatuar se për shkak të dështimit të kontraktimit të operatorit ekonomik për shërbime postare, afatet e parashikuara fillimisht nuk ishin më të realizueshme.

Në këto rrethana, me qëllim të garantimit të së drejtës së votës dhe përmbushjes së detyrimit për dërgimin e fletëvotimeve tek votuesit jashtë vendit, KQZ-ja ka bërë plotësimin dhe ndryshimin e afateve për dërgimin e pakove. Vendimi specifikon po ashtu se tërheqja e pakove me fletëvotime bëhet me datë 02.01.2026, përveç në rastet kur shërbimet postare nuk operonin në këtë datë për shkak të festave të fundvitit dhe duke qenë se datat 3 dhe 4 janar ishin ditë vikendi, tërheqja duhej të bëhej në ditën pasuese të punës, përkatësisht më 05.01.2026.

Gjatë procesit të vendimmarrjes janë marrë parasysh vonesat që festat e fundvitit shkaktojnë në procesimin e kthimit të pakove nga 22 shtete të ndryshme drejt Kosovës. Kjo vendimmarrje është bazuar plotësisht në Ligjin Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht në Nenin 5, paragrafin 6, i cili autorizon KQZ-në që në proceset e zgjedhjeve të parakohshme, të ndryshojë afatet kohore sipas nevojës dhe në pajtim me rrethanat e krijuara. Po ashtu si shembull pas komunikimit me Postën në Shtetin e Zvicrës të njëjtit kanë konfirmuar se data 29.12.2025 nuk ishte ditë pune dhe nuk mund të bëhej tërheqja e pakove me fletëvotime. Vendimi i KQZ për shkurtimin e afateve, i miratuar më 10.12.2025, është miratuar me votat e të gjithë anëtarëve të KQZ-së, për çka kishte pajtueshmëri në mesin e të gjithë anëtarëve të KQZ-së, dhe se përveçse nuk është kontestuar nga asnjë palë, ka orientuar secilin akterë që të veprojë në përputhje me këto afate të përcaktuara. Po ashtu, votuesit kanë qenë të njoftuar që para ditës së zgjedhjeve se deri në cilën datë duhet të arrijnë dërgesat postare nga vendi përkatës. Për të përmbushur parimet ligjore të parashikueshmërisë dhe të sigurtë juridike, vendimi ka qenë publik. Ndryshimi i rregullave pasi që janë pranuar zarfet cenon sigurinë juridike. KQZ përmes Zyrtarëve të Përfaqësive Diplomatieke ka realizuar procesin e tërheqjes së pakove me fletëvotime në disa faza përgjatë periudhës dhjetor 2025 - janar 2026, duke përfshirë gjithsej 22 kuti postare në vende të ndryshme dhe në Kosovë. Procesi nisi më 23 dhjetor 2025 me tërheqjet fillestare në Bernë (8,000 pako) dhe Berlin (10,511 pako), duke u pasuar më 29 dhjetor me një sasi shtesë prej 10,044 pakosh po ashtu nga Berlini. Faza tjetër u realizua më 2 janar 2026, datë në të cilën u procesuan tërheqjet në një numër të madh qendrash ndërkombëtare si: Praga, Londra, Zagrebi, Stokholmi, Stambolli, Nju Jorku, Kopenhaga, Kanbera dhe Parisi. Së fundmi, për shkak të festave dhe ditëve të vikendit, tërheqja u përmyll më 5 janar 2026. Në këtë datë u realizua tërheqja në Prishtinë dhe në qendra të tjera si: Vjena, Brukseli, Oslo, Roma, Lubjana, Budapesti, Shkupi, Tirana, Haga, Otava, Podgorica, si dhe sasi të mbetura nga Berna dhe Berlini. Ky koordinim i datave reflekton përshtatjen e procesit operacional me funksionalitetin e shërbimeve postare dhe kalendarin e festave zyrtare, duke siguruar

grumbullimin e pakove me fletëvotime nga të gjitha kutitë postare. Një praktikë e tillë është aplikuar edhe në Zgjedhjet Lokale 2025, përkatësisht në Raundin e dytë të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave të mbajtur me date 9 nëntor 2025, ku KQZ kishte vendosur që për shkak të afatit të shkurtë në dispozicion për votuesit që të kthejnë fletëvotimet, tërheqja të bëhej me date 11.11.2025 dhe në vendet ku data 11.11.2025 ishte festë zyrtare tërheqja të bëhej në ditën vijuese të punës respektivisht me datë 12.11.2025. Në këtë kuptim, në numërimin e datës 7 janar, përveç fletëvotimeve të numëruara nga tërheqjet e bëra me datë 2 dhe 5 janar 2026, kishte edhe zarfe me fletëvotime të cilat i takonin tërheqjeve të mëhershme e të cilat nuk janë numëruar për faktin se ishin në numër të vogël dhe sipas procedurës duhej të bashkohej me fletëvotime të njëjtës komunë nga tërheqjes e radhës deri në plotësimin e kriterit rreth 300 fletëvotime në një kuti apo vendvotim. Gjatë procesit të vlerësimit të pakove me fletëvotime përmes postës, janë refuzuar 149 zarfe të cilat kishin arritur në kutitë postare pas datës 27 dhjetor 2025.

Përcaktimi i afateve nga ana e KQZ-së nuk përbën vetëm një veprim administrativ të bazuar në Nenin 5, paragrafin 6 të Ligjit Nr. 08/ L-228, por është një veprim i domosdoshëm për të garantuar parimin e gjithë përfshirjes dhe realizimin efektiv të së drejtës së votës, të garantuar me Nenin 45 të Kushtetutës së Kosovës, sepse në të kundërtën shkurtimi dhe kufizimi i afateve të tërheqjes do të rezultonte në pamundësinë teknike të mijëra votuesve jashtë vendit për të pranuar dhe kthyer fletëvotimet e tyre brenda kohës, Prandaj, përshtatja e kalendarit të tërheqjeve ishte mjeti i vetëm që mundëson përfshirjen e votuesve në procesin vendimmarrës, duke parandaluar përjashtimin e tyre de facto nga zgjedhjet.

Ankesa lidhur me shkeljen e supozuar e cila sipas palës ankuese ka ndodhur në QNR, dhe në kuptim të saj edhe pala e ka parashtruar atë, në kontekstin ligjor është e pasafatshme, pasi që sipas nenit 105 paragrafi 1 të Ligjit për Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, "Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QI(N dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar. ”

Në kuptim të kësaj, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka përmbyllur procesin e numërimit të fletëvotimeve me postë jashtë Kosovës në QNR, me datë 09.01.2026, në ora 02:00 të mëngjesit (njoftimin zyrtar të publikuar në ueb faqen e KQZ-së). Fakti se procesi i numërimit në QNR është përmbyllur në ora 02:00, dëshmohet përmes email-it zyrtar të U.D Drejtorit të Sekretariatit të KQZ-së. Po ashtu, për përmbylljen e këtij aktiviteti si dhe për të drejtën e palëve për parashtrimin e ankesës në administrimin e numërimit në QNR, ka pasur njoftime të shumta në media të ndryshme.

Andaj, konsiderojmë se pala, e cila ka parashtruar ankesën në PZAP më 11.01.2026, në ora 12:50, e ka bërë këtë jashtë afatit ligjor, të përcaktuar qartë në dispozitën ligjore të lartcekur.

Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese lidhur me përfshirjen e një numri të fletëvotimeve pas afatit ligjor në rezultatin zgjedhor, ju njoftojmë se KQZ nuk ka shpallur ende rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, pasi që ato shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevojë të veçanta; fletëvotimeve nga votimi

jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNRJ ku rezultati i publikuar është i ankimueshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre. Në përfundim, ankesa e dorëzuar me datë 11.01.2026 është e pasafatshme, pasi konteston vendimin e KQZ-së të datës 10.12.2025 dhe veprimet e tërheqjes së pakove me fletëvotime të realizuara më 02 dhe 05 janar 2026.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes së KQZ-së, vlerësoj se:

Ankesa është e pas afatshme

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën me datë 11.01.2026, me të cilën ka kërkuar që të urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të anulohet të gjitha fletëvotimet të pranuar me postë pas datë 29.12.2025 dhe të përjashtoj nga numërimi të gjitha fletëvotimet të pranuar pas këtij afati përfshirë ato të pranuar me 02.01.2026 dhe 05.01.2026, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025.

Paneli ka vlerësuar se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 119, paragrafi 1 të LJP-së, ku afati për dorëzimin e ankesës është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe se ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 11.01.2026, ndërsa shkelja e supozuar sipas ankuesit ka ndodhur me datën 02.01.2026 dhe 05.01.2026 duke qenë se ankuesi ka kërkuar që të urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të anulohet të gjitha fletëvotimet të pranuar me postë pas datë 29.12.2025 dhe të përjashtoj nga numërimi të gjitha fletëvotimet të pranuar pas këtij afati përfshirë ato të pranuar me 02.01.2026 dhe 05.01.2026, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025.

Me që pala ankuese në ankesë ka kërkuar që të anulohen fletëvotimet me postë dhe të përjashtohen nga numërimi të gjitha fletëvotimet e pranuar me datë 02.01.2026 dhe 05.01.2026, pra që ndërlihet me datën e pranimit të fletëvotimeve me postë, në këto rrethana paneli vlerësoj se shkelja e supozuar sipas pretendimeve ankimore kane ndodhur me 02.01.2026 dhe 05.01.2026, ndërsa ankesa është parashtruar me 11.01.2026, paneli vlerësoi se e njëjta është paraqitur pas afatit ligjor.

Lidhur me pretendimin në ankesë ku është theksuar se në bazë të nenit 105 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, përcaktohet e drejta për parashtrimin e ankesës në afat prej 48 orësh nga ndodhja e shkeljes së supozuar në procesin e QNR sepse ka të bëjë me ligjshmërinë e përfshirjes në numërim të një kategorie fletëvotimesh pas afati ligjor në rezultatin zgjedhor, çka përbën element vendimtar të aktit përfundimtar të shpalljes dhe certifikimit, e cila është bërë e ditur zyrtarisht nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në njoftimin e publikuar të datës 9 janar 2026, për panelin pretendimet e theksuara lidhur me shkeljet e supozuar në QNR, janë të pasafatshme, pasi që sipas nenit 105 paragrafi 1 të Ligjit për Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, "Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QI(N

dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, ndërsa Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka përmbyllur procesin e numërimit të fletëvotimeve me postë jashtë Kosovës në QNR, me datë 09.01.2026, në ora 02:00 të mëngjesit - njoftimi zyrtar të publikuar në ueb faqen e KQZ-së.

Paneli ka gjetur se ankuesi lidhur me këto pretendime ka qene dashur ti paraqiste brenda afatit te parapare ligjor respektivisht ne fazat e mëhershme.

Ne këtë këndvështrim duhet pas parasysh se KQZ ka nxjerre Vendimin Nr.01/3794-2025 me te cilin është miratuar rekomandimi për afatet dhe veprimet për dërgimin dhe pranimin e pakove dhe fletëvotimet për votim me poste, ky vendim i apostrofuar nuk është kontestuar respektivisht nuk eshte ankimuar nga asnjëra pale, e as nga subjekti ankues.

PZAP sqaron se e drejta e ushtrimit te mjetit juridik eshte e kushtezuar me respektimin e afateve te percaktuara nga ligji, ankesa e paraqitur pas afatit nuk mund te merret ne shqyrtim meritor sepse afati per ushtrimn e ankeses eshte afati prekluziv dhe humbja e tij sjell humbjen e te drejtes se ankimimit.

Andaj Paneli ka gjetur se ankesa e parashtruar nga Subjekti Politik PDK, është e pasafatshme edhe duke u mbështetur në dispozitën e nenit 9 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, ku parashihet që *“Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara”*.

Neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, parasheh që: *“PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor.”* PZAP-i vendosi që të hedhë ankesën e ankuesës pasi që ankesa është parashtruar si e pasafatshme.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 118 paragrafi 1 dhe 119 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës lidhur me nenin 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.16, nenin 13, paragrafi 2, neni 13 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Rregullës 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZP.Anr.73/2025, datë 12.01.2026



Këshillë Juridike; kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.